Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-758
Datë: 06.08.2026

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e V të mbajtur me datë 06.08.2026 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Akreditohet dhe validohet**, Instiutucioni për Aftësim Profesional, "ScanTech Academy" Rr. Tahir Sinani, Lipjan dhe Rr. UCK, nr. 92, Prishtinë, Republika e Kosovës për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 06.08.2026 deri 05.08.2029 me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

1.1. *Kurse të Gjuhës Angleze (A1 – C1) sipas CEFR,* Institucioni mund të organizojë kurse të rregullta, intensive dhe trajnime individuale për nivelet A1–C1. Numri i kandidatëve për një grup në kurset e rregullta dhe intensive mund të jetë deri në 16 kandidatë/nxënës, ndërsa në trajnimet individuale merr pjesë 1 kandidat. Institucioni mund të realizojë nga 1 deri në 8 grupe në javë për secilin nivel, varësisht nga programi (i rregullt, intensiv apo individual) dhe lokacioni. Numri i cikleve (grupeve) në vit ndryshon sipas nivelit, ku për nivelet A1, A2, B1 dhe B2 mund të realizohen deri në 16 grupe/cikle në vit, ndërsa për nivelin C1 mund të realizohen deri në 2 grupe/cikle në vit. Me deri në 16 kandidatë/nxënës për grup, për nivelet A1, A2, B1 dhe B2 mund të trajnohen deri në 256 kandidatë/nxënës në vit (16 × 16 = 256 kandidatë/nxënës), ndërsa për nivelin C1 mund të trajnohen deri në 32 kandidatë/nxënës në vit (2 × 16 = 32 kandidatë/nxënës).

1.2. *Kurse të Gjuhës Gjermane (A1 - B2) sipas CEFR,* Institucioni mund të organizojë kurse të rregullta, intensive dhe trajnime individuale për nivelet A1–B2. Numri i kandidatëve për një grup në kurset e rregullta dhe intensive mund të jetë deri në 14 kandidatë/nxënës, ndërsa në trajnimet individuale merr pjesë 1 kandidat. Institucioni mund të realizojë nga 1 deri në 6 grupe në javë për secilin nivel, varësisht nga programi (i rregullt, intensiv apo individual) dhe lokacioni. Numri i cikleve (grupeve) në vit ndryshon sipas nivelit, ku për nivelin A1 mund të realizohen deri në 14 grupe/cikle në vit, për nivelin A2 deri në 8 grupe/cikle, për nivelin B1 deri në 5 grupe/cikle, ndërsa për nivelin B2 mund të realizohen deri në 4 grupe/cikle në vit. Me deri në 14 kandidatë/nxënës për grup, për nivelin A1 mund të trajnohen deri në 196 kandidatë/nxënës në vit (14 × 14 = 196 kandidatë/nxënës), për nivelin A2 deri në 112 kandidatë/nxënës në vit (8 × 14 = 112 kandidatë/nxënës), për nivelin B1 deri në 70 kandidatë/nxënës në vit (5 × 14 = 70 kandidatë/nxënës), ndërsa për nivelin B2 mund të trajnohen deri në 56 kandidatë/nxënës në vit (4 × 14 = 56 kandidatë/nxënës).

1. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së Instiutucionit për Aftësim Profesional, "ScanTech Academy", Rr. Tahir Sinani, Lipjan dhe Rr. UCK, nr. 92, Prishtinë, për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve, si dhe raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit 17.06.2026 dhe 18.06.2026 për kualifikimin: ndërsa vizita është realizuar me datën 23.01.2026. Takimi konsultativ me përfaqësuesit e institucionit: 04.06.2026, shqyrtimi i dokumentacionit shtesë: 29.06.2026, Pas përfundimit të procesit vlerësues, raportet janë realizuar me datë: 23.07.2026 dhe 24.07.2026. Bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 06.08.2026

Këshilli Drejtues i AKK-së gjatë vendimmarrjes për akredimit ka marr parasysh faktin se institucioni kishte aplikuar brenda afatit ligjor për ri akreditimin e kualifikimit si dhe kohën e shqyrtimit të dosjes së aplikimit, nga momenti i dorëzimit të kërkesës.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.*

Vendimi u dërgohet:

1. "ScanTech Academy" Prishtinë
2. Arkivit të AKK.

Prof. Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK

Sa i përket punësimit:

Ligji i punës, dhe të gjithave Udhëzimeve Administrative që dalin nga ky ligj;

Sa i përket mbrojtjes së fëmijëve:

Kodi penal i Republikës së Kosovës;
Kodi i drejtësisë për të mitur.

Sa i përket mundësive të barabarta:

Ligji për barazi gjinore, dhe të gjithave Udhëzimeve Administrative që dalin nga ky ligj;
Ligji Kundër Diskriminimit, dhe të gjithave Udhëzimeve Administrative që dalin nga ky ligj.

Sa i përket të drejtës së autorit:
Ligji për të Drejtat e Autorit, dhe të gjithave Udhëzimeve Administrative që dalin nga ky ligj.

Unë, konfirmoj që ofruesi i poshtëpërmendur është në përputhje me të gjitha legjislacionet e zbatueshme dhe kërkesat rregullative.

Nënshkrimi:

Emri: AGRON MEGJINOLLI

Pozita: DREJTOR

Emri i ofruesit: SCANTECH ACADEMY

Data e deklarimit: 11.08.2026

Vula:

NUI:810193326
Scantech
ACADEMY